



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. _____

Pershendetje

Në përgjigje të e-mail Tuaj, administruar nga Bashkia Shkodër me nr.6397 Prot, datë 28.03.2024, Ju informojmë si më poshtë,

Projektet dhe problematikat në zonën e Pedonales të Shkodrës

Bazuar në Kodin e Proçedurës Administrative referuar ligjit 9780 datë 16.07.2016 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme” i azhornuar, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Në lidhje me përgjigjen e pikës së 4. sqarojmë se:

IMT-ja Bashkia Shkodër pasi ka patur nen kontroll dhe në vëmendje zonën si zonë e rëndësisë së vecantë nuk ka konstatuar parregullsi. Punimet e kryera me zhvillues persona fizik në këtë zonë janë zhvilluar në zbatimin të lejeve të miratuara.

Në lidhje me përgjigjen e pikës së 7. sqarojmë se:

Punimet e projektit “Restaurimi i fasadës–rindërtim i Kafes së Madhe dhe ndërtim i ambienteve ndihmëse” janë pajisur me leje ndërtimi dhe punimet për zbatimin e saj janë ndërprerë nga vet subjekti ndërtues.

Në këto kushte IMT-ja nuk ka vendimarrje për ndërprerje punimesh.

Në lidhje me pikën 6, Ju bëjmë me dije se,

Bashkia Shkodër me vendim nr. 320, datë 26.12.2017, ka miratuar lejen e ndërtimit për objektin “Restaurim i godinës “Kafja e Madhe” Shkodër, faza parë”, me zhvillues “XHENIS”

sh.p.k., pronar Belma Çela, Agron Çela dhe subjekt ndërtues “BH&SB” sh.p.k, bazuar në vendimin e Këshillit Kombëtar të Restaurimeve me nr.168, datë 08.07.2016.

Sa i perket kërkesave tjera, jemi te paqarte ne lidhje me objektin e kërkeses ngaqë behet fjale per nje mori investimesh qe mund te preken ne zonen e kerkuar, te cilat nuk jane vetem ne varesi te fondeve te bashkise si dhe nuk eshte e qarte a behet fjale per investime ne infrastrukture apo edhe ne aspekte te tjera.

Sa me siper, ju falenderojme per interesimin tuaj, dhe mbetemi ne kontakt per cdo paqartesi.

Pune te mbare!

KRYETAR

Benet BECI